

L I G J
Nr.8468, datë 31.3.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE “MEDIOCREDITO CENTRALE” ITALI, PËR
PROGRAMIN E MBËSHTETJES SË BILANCIT TË PAGESAVE”**

Në mbështetje të neneve 81 e 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe “Mediocredito Centrale” Itali, për programin e mbështetjes së bilancit të pagesave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2347, datë 13.4.1999 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

MARRËVESHJE
FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
"MEDIOCREDITO CENTRALE" ITALI, PËR PROGRAMIN E MBËSHTETJES SË
BILANCIT TË PAGESAVE

MARRËVESHJE FINANCIARE

Në përputhje me Nenin 6 të Ligjit Nr.49, datë 26.02.1987 të Republikës Italiane,
Ndërmjet: Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (që tani e tutje i quajtur
Huamarrësi), duke vepruar nëpërmjet Bankës Tregtare Tiranë, Shqipëri,
përfaqësuar nga njëra anë nga Spiro Brumbulli

Dhe: Mediocredito Centrale - Instituti Qendror për Kreditin Afatmesëm S.P.A., në
formë të shkurtuar Mediocredito Centrale S.P.A., me zyrë të regjistruar në Romë, Rruga
“Piemonti 51”, regjistruar në Gjykatën e Romës në 3362/94, reg.Soc. me regjistrin e Bankës
Nr.74762.6.0, me aksione Lit. 2.148.221.200.000, reserva Lit. 264.140.068.026, tax kodë Nr.
00594040586 (që tani e tutje e quajtur Mediocredito Centrale) si administratore e Fondit të krijuar
me Nenin 6 të Ligjit Italian Nr.49 të 26 Shkurtit 1987, përfaqësuar nga ana tjetër, nga z.Roland
Murari, Drejtor, dhe zoti Maurizio Cervi, zëvendës drejtor.

Me qenë se:

Ministria e Thesarit e Qeverisë së Republikës të Italisë, me propozim të Ministrit të

Punëve të Jashtme, me dekret Nr.617096, datë 23 Mars 1998, ka autorizuar Mediocredito Centrale të japë një kredi financiare për Lit. 22.000.000.000 (njëzet e dy miliardë) për Republikën e Shqipërisë, me kushtet e mëposhtme:

- Shlyerja: me 36 këste principale të barabarta 6-mujore, ku e para do të skadojë 150 (njëqind e pesëdhjetë) muaj pas datës së bërjes efektive të Konventës Financiare.

- Norma e interesit: interesi vjetor nominal 1%, i pagueshëm në fundin e çdo periudhë 6-mujore nga data e secilit disbursim.

- Qëllimi i kredisë: importimi i mallrave dhe shërbimeve italiane në kuadrin e programit të

mbështetjes së bilancit të pagesave.

- Valuta e disbursimit: kredia financiare do të disbursohet në lira italiane.

- Kjo kredi do të përdoret gjithashtu për vlerën 230.850.000 lireta (dyqind e tridhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë), për të financuar veprimtarinë e “prokurimit” për realizimin e programit. Transaksionet, që do të financohen, do të komunikohen drejtpërsëdrjti nga Drejtoria e Përgjithshme për Kooperimin për Zhvillim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë.

Tani, dhe për këto arsye:

Duke e konsideruar edhe hyrjen, si një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me anekset përkatëse, Palët bien dakord, si më poshtë:

Neni 1

Kredia financiare

1.1. Mediocredito Centrale i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi financiare deri në shumën maksimale prej Lit. 22.000.000.000 (njëzet e dy miliardë)

1.2. Kredia në fjalë do të përdoret për importimin e mallrave dhe shërbimeve italiane në kuadrin e programit të mbështetjes së bilancit të pagesave.

1.3. Shpërndarja përfundimtare e kësaj kredie për kontratën e furnizimit, që i referohet pikës 1.2 më sipër, do t'i komunikohet nga Mediocredito Centrale, huamarrësit dhe Bankës Agjente menjëherë, sapo kushtet që kërkohen nga rregullat italiane të jenë plotësuar. Shpërndarja në fjalë do të kryhet brenda periudhës së vendosur në Nenin 4, paragrafi 4.2.

1.4. Kredia financiare do të vihet në dispozicion dhe do të përdoret në përputhje me kushtet dhe afatet e shprehura në këtë marrëveshje, pavaresisht nga qendrimet e ndryshme të autoriteteve qeveritare kompetente italiane.

Neni 2

Banka Agjente

2.1. Është rënë dakord që Banka Agjente për këtë kredi do të jetë Dega Romë e Institutit San Paolo Torino S.P.A (e quajtur që këtej e tutje Banka Agjente).

2.2. Banka Agjente do të hapë një “Llogari me Jashtë” në emër të Huamarrësit.

2.3. Banka Agjente në lidhje me dispozitat në fuqi në Itali, do të kontrollojë që pagesat që do të behen në kuadrin e kredisë, janë në përputhje me ligjin e kontrollit të këmbimit të valutës, që është në fuqi në Itali.

2.4. Banka Agjente do të bëjë pagesat e duhura në lidhje me Marrëveshjen kundrejt lëvrit, nga përfuturit italiane, të dokumenteve kontraktuale të kerkuar nga kontrata e furnizimit dhe vërtetime të shkarkimit të mallrave, në dy kopje origjinale. Banka Agjente do të dërgojë një kopje origjinale të vërtetimit dhe të dokumenteve kontratuese Mediocreditos Centrale dhe do t'i

transmetojë origjinalin e dyte të vërtetimit dhe të dokumenteve kontraktuale Huamarrësit.

Neni 3

Efektiviteti i Marrëveshjes Financiare

3.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive sapo Mediocredito Centrale të ketë marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme:

i) Deklaratë nga autoritetet kompetente të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, që të vërtetojë se firmat në këtë Marrëveshje janë ato të personave që kanë plotfuqishmëri sipas ligjeve, rregullave dhe dispozitave në fuqi në Shqipëri, për të marrë përsipër detyrimet që lindin në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje për Huamarrësin.

ii) Një dokument me shkrim nga Huamarrësi ku të caktohet personi ose personat që kanë plotfuqishmëri për të firmosur Deklaratën e Borxhit, që i referohet Nenit 8 më poshtë dhe dokumente të tjera të parashikuara në këtë Marrëveshje, modelet e të cilëve janë përfshirë në këtë Marrëveshje, si Aneksat A, B, C dhe E, ky dokument duhet të përcaktojë gjithashtu, emrin dhe postin e personave në fjalë, si dhe të përmbajë specialitetet e firmave të personave në fjalë, huamarrësi do të transmetojë këtë dokument, si dhe specimentet e firmave Bankës Agjente.

iii) një kopje e udhëzimeve të dhena Bankës Agjente për të hapur një “Llogari me Jashtë” në emër të Huamarrësit dhe të përdorimit të fondeve të kredituara në këtë llogari për qëllimin ekskluziv të kryerjes së pagesave që Huamarrësi do të kërkojë dhe në përputhje me kushtet e specifikuar nga ai; udhëzime të tilla që do të jenë në formën e Aneksit A, do të pranohen nga Banka Agjente me shkrim Mediocreditos Centrale.

3.2. Mediocredito Centrale, sapo të marrë dokumentet e mësipërme, do të njoftojë Huamarrësin me letër ose teleks, të konfirmuar me pas me letër, si dhe Bankën Agjente për datën kur kjo Marrëveshje do të bëhet efektive.

Neni 4

Valuta dhe periudha e disbursimit të kredisë financiare

4.1. Kredia financiare do të disbursohet në lira italiane në përputhje me klauzolat e hyrjes së Marrëveshjes.

4.2. Fondet do të kreditohen në një ose me shumë herë, në “Llogarinë me Jashtë” brenda 24 muajve nga data e bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim, kur për shtyrjen e afatit bien dakord të dy palët, duke iu nënshtruar autorizimit, në qoftë se është e nevojshme, të autoriteteve italiane dhe shqiptare.

4.3. Kredia financiare do të përdoret pas datës dhe bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje, datë, e cila do të jetë njoftuar nga ana e Mediocredito Centrale, Huamarrësit dhe Bankës Agjente, në përputhje me Nenin 3 të mësipërm.

Neni 5

Kushtet për përdorimin e fondeve; kërkesa për të kredituar fondet

5.1. Mbasi kjo Marrëveshje do të jetë bërë efektive, Huamarrësi do t'i transmetojë Mediocredito Centrale një kërkesë për të pasur në dispozicion fondet e nevojshme për pagesat për secilën nga kontratat e furnizimit, ku dhënia e kredisë do të autorizohet nga autoritetet kompetente italiane dhe do të njoftohet Huamarrësi me shkrim, në lidhje me klauzolat e Nenit 1; paragrafi 1.3. Kjo kërkesë do të ketë formën e Aneksit B.

5.2. Huamarrësi do t'i dërgojë Bankës Agjente një letër me udhëzime, në formën e Aneksit C, për secilën kontratë të përmendur më sipër, e cila do të pranohet duke u shprehur nga Banka Agjente, që do të njoftojë për këtë me shkrim vetë Huamarrësin dhe Mediocredito Centralen.

5.3. Duke ndjekur udhëzimet e sipërpërmendura të Huamarrësit, Banka Agjente do t'i kërkojë Mediocreditos Centrale, herë pas here të kreditojë "Llogarinë me Jashtë" të Huamarrësit me fonde të nevojshme për të bërë pagesat e parashikuara në kontratën e furnizimit në lidhje me kushtet e vendosura në Nenin 6 më poshtë. Banka Agjente do të përgatisë kërkesat për të kredituar sipas Aneksit D dhe do të transmetojë një kopje Huamarrësit.

Neni 6

Kushtet për përdorimin e fondeve; kreditimi i fondeve

6.1. Përdorimi i kredisë financiare do të bëhet në përputhje me kushtet e shprehura më poshtë.

6.2 Pas marrjes së kërkesës për të pasur fondet në dispozicion, sipas Nenit 5, paragrafi 5.1, Mediocredito Centrale do të zbatojë kërkesën për të kredituar fondet, të cilën Banka Agjente do të bëjë në emër të Huamarrësit, sipas udhëzimeve të këtij të fundit.

6.3. Çdo kërkesë për kreditim do të tregojë numrin dhe datën e kontratës së furnizimit, emrin e importuesit shqiptar dhe të eksportuesit italian, shumën që do të disbursohet, një vërtetim nga Banka Agjente mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë e dokumenteve kontraktuale me kontratën e furnizimit, të cilës i referohen. Originali i këtyre dokumenteve kontraktuale do t'i transmetohet Huamarrësit nga Banka Agjente.

6.4. Çdo kërkesë për kreditim, do të ekzekutohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas marrjes së saj nga Mediocredito Centrale, në rastin kur fondet janë në dispozicion nga autoritetet qeveritare italiane.

6.5. Çdo kërkesë për kreditim do të paraqitet sa herë të kryhet pagesa përkatëse sipas kushteve të kontratës.

6.6. Me marrjen e secilës nga kërkesat e mësipërme për kreditim, Mediocredito Centrale do t'i japë udhëzimet e nevojshme Bankës Agjente për kreditimin e fondeve në "Llogarinë e Jashtme", të hapur me të në emër të Huamarrësit dhe do t'i konfirmojë atij me telex shumën totale të disbursimit dhe datën aktuale të kreditimit.

6.7. Në të njëjtën kohë që fondet janë kredituar në "Llogarinë me Jashtë", Banka Agjente do të bëjë pagesat sipas kontratës së furnizimit në favor të eksportuesve italianë dhe do të marrë prej tyre vërtetimin e shkarkimit të mallit në dy origjinale, një nga të cilat do t'i dërgohet Huamarrësit bashkë me dokumentet kontraktuale të lëshuara për të njëjtat pagesa dhe tjetra Mediocreditos Centrale bashkë me kopjen e po këtyre dokumenteve kontraktuale.

6.8. Pas çdo kreditimi të fondeve në "Llogarinë me Jashtë" dhe pas pagave korresponduese në favor të përfituesve të mësipërm, Mediocredito Centrale do t'i transmetojë me letër Huamarrësit dhe një kopje Bankës Agjente, afatin e shlyerjes së shumës së disbursuar, duke dhënë edhe datat e skadencës. Kjo tabelë e shlyerjes së pagesave, e plotësuar në përputhje me kushtet e vendosura në nenin 7, do të pranohet nga Huamarrësi me shkrim.

6.9. Në qoftë së Banka Agjente nuk është në gjendje të bëjë pagesat në favor të përfituesve të sipërpërmendur në datën e caktuar për kreditimin e fondeve në "Llogarinë me Jashtë", Banka Agjente në fjalë nuk do të plotësojë udhëzimet për kreditim të Mediocreditos Centrale dhe të informojë menjëherë Huamarrësin dhe Mediocredito Centrale me shkrim.

6.10. Menjëherë, sapo arsyja që pengoi pagesat për përfituesit të jetë eliminuar, Banka Agjente duhet t'i dërgojë Mediocreditos Centrale një kërkesë tjetër për kreditim.

6.11. Mediocredito Centrale rezervon të drejtën të mos plotësojë asnjë kërkesë për kreditim në "Llogarinë me Jashtë", kur rezultojnë mospërmbushje me Mediocredito Centrale në lidhje me kredinë në fjalë ose kredi të tjera financiare, akorduar nga Mediocredito Centrale Qeverisë ose Bankës Qendrore ose Enteve Publike të Republikës së Shqipërisë, sipas Nenit Nr.6 të Ligjit Nr.38, datë 9 Shkurt 1979 dhe Nenit 6 të ligjit italian Nr.49, data 26 Shkurt 1987, bashkë me modifikimet.

Neni 7

Shlyerja e kredisë financiare dhe pagesa e interesave

7.1. Çdo shumë e kredituar në “Llogarinë me Jashtë” do të shlyhet sipas tabelës së shlyerjes që Mediocredito Centrale do t’i dërgojë Huamarrësit dhe një kopje Bankës Agjente në lidhje me Nenin 6, paragrafi 6.8.

7.2. Çdo shumë kredituar në “Llogarinë me Jashtë” do të shlyhet në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të njëpasnjëshme, të barabarte gjysmëvjetore (këstet kryesore), ku e para do të skadojë 150 muaj (njëqind e pesëdhjetë) nga data e bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje.

7.3. Në këstet e shumës principiale që kanë të bëjnë me çdo kreditim në “Llogarinë me Jashtë”, interesi do të llogaritet me një normë vjetore nominale 1% (një për qind) e barabartë me 0.50% (zero pesëdhjetë) për gjysmë viti, duke u nisur nga data e kreditimit deri në datën e shlyerjes së këstit të fundit.

7.4. Gjatë periudhës së rishlyerjes, interesi do të paguhet në të njëjtën ditë me këstet e principialit. Gjatë periudhës së faljes, interesi do të paguhet çdo gjashtë muaj në datat, që korrespondojnë në ditë dhe muaj me datat e shlyerjes së kësteve të principialit. Si rrjedhojë, kësti i parë i interesit, relativisht, mund të lidhet me një periudhë më të vogël se ajo 6-mujore. Megjithatë, edhe sikur kjo periudhë të rezultonte më të vogël se 30 ditë, kësti i interesit korrespondues do të paguhej bashkë me këstin e interesit pasardhës.

Kësti i parë i interesit që ka të bëjë me një periudhë për më pak ose me shumë se gjashtë muaj, do të llogaritet për ditët aktuale midis datës së kreditimit në “Llogarinë me Jashtë” dhe datës së pagesës së tyre mbi bazat e një 6-mujori prej 180 ditësh.

7.5. Pagesa e interesit, e lidhur me çdo disbursim, do të bëhet në datat e treguara në tabelën e shlyerjeve, sipas Nenit 6, paragrafi 6.8, deri në datën e lëshimit të Deklaratës së Borxhit që i referohet Nenit 8, më poshtë, për periudhën e mëposhtme shlyerja e principialit dhe pagesa e interesave në datat e treguara në tabelën e shlyerjeve që i ngjitet Deklaratës së Borxhit të lartpërmendur.

Neni 8

Lëshimi i Deklaratës së Borxhit

8.1. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e skadimit të disbursimit të fundit të kredisë financiare, është e shprehur në Nenin 4, paragrafi 4.2, Huamarrësi do t’i lëshojë Mediocredito Centrale një Deklaratë për Borxhin e sigluar në çdo faqe dhe të firmosur, në formën e Aneksit E, me kërkesat e mëposhtme:

a) Shuma e principialit: Deklarata e Borxhit do të përpilohet në një shumë totale, që i korrespondon totalit të shumave të disbursuara;

b) Interesi: me normën e shprehur në Nenin 7, paragrafi 7.3;

c) Përfituesi: në emër të Mediocredito Centrale;

d) Vendi dhe data e lëshimit: do të tregohet në kohën e firmosjes;

e) Adresa: të gjitha shumat e treguara në Deklaratën e Borxhit, do t’i paguhet nga Huamarrësi Mediocredito Centrale, respektivisht në datat e skadencës pranë Bankës Agjente.

f) Transferimi: Deklarata e Borxhit, akoma e pamaturuar, është e lirë të transferohet nga Mediocredito Centrale në një person juridik italian privat ose shtetëror. Transferimi në një person juridik privat ose shtetëror të jashtëm, i nënshtrohet më parë miratimit të Huamarrësit. është e kuptueshme se Huamarrësi nuk do të jetë përgjegjës për çdo komision, taksë ose shpenzim, që do të vijë si rezultat i transferimit të Deklaratës së Borxhit. Mediocredito Centrale do të njoftojë Bankën Agjente për transferimin e Deklaratës së Borxhit.

g) Datat e skadimit dhe plani i shlyerjes së kredisë financiare: Plan i shlyerjes së shprehur në Deklaratën e Borxhit do të përpilohet duke mbledhur të gjitha kuotat e principialit dhe të interesave ende të pamaturuara në datën e lëshimit të Deklaratës së Borxhit, që rezultojnë

nga çdo plan shlyerjeje, të kryera në fillim të çdo disbursimi sipas klauzolave të Nenit 6, paragrafi 6.8.

8.2. Mediocredito Centrale do të depozitojë Deklaratën e Borxhit për ruajtje dhe administrim pranë Bankës Agjente, pasi kjo Deklaratë Borxhi të jetë miratuar në favor të Bankës Agjente.

8.3. Banka Agjente, herë pas here, do të shënojë në Deklaratën e Borxhit çdo pagesë të bërë të principialit dhe të interesave dhe sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e parashikuara në Deklaratën e Borxhit dhe Banka Agjente do t'ia kthejë Deklaratën Huamarrësit, të firmosur dhe të vërtetuar.

Neni 9

Vendi dhe kushtet e pagesave. Angazhimi i Huamarrësit

9.1. Për të gjitha pagesat dhe shlyerjet që do të bëhen në kuadrin e Marrëveshjes, si dhe në atë të Deklaratës së Borxhit, të lidhur me të, Huamarrësi do të kreditojë Bankën Agjente pa asnjë vonesë dhe në datat e caktuara për shumën përkatëse në lireta italiane në favor të Mediocreditos Centrale ose të personave të autorizuar. Shumat në fjalë do kreditohen pa zbritje të komisioneve bankare ose shpenzimeve të këmbimit dhe pa qenë e nevojshme të lajmërohen nga ana e Mediocredito Centrale ose atyre që kanë të drejtën e përfaqësimit të saj.

9.2. Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat në kuadrin e Marrëveshjes dhe Deklaratës së Borxhit, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i pakthyeshëm.

Neni 10

Interesi i munguar

10.1. Në qoftë se Banka Agjente për çfarëdo arsye, qoftë edhe për arsye që nuk varen nga vullneti i Huamarrësit, nuk merr shumat e duhura për principilain dhe interesat brenda datave të caktuara, Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Bankës Agjente për shumat në fjalë, interesin e munguar, nga data e caktuar deri në datën aktuale të kreditimit, në favor të Mediocreditos Centrale ose të personave të tjerë të emëruar.

10.2. Ky interes i munguar do të llogaritet me normën 1% (një për qind) për periudhën e 35 (tridhjetë e pesë) ditëve menjëherë pas datës fillestare të skadencës dhe me normë 5% (pesë për qind) deri në datën aktuale të kreditimit në favor të Mediocreditos Centrale.

10.3. Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët e para pas datës fillestare të skadimit, ky interes i munguar do të llogaritet duke përdorur formulën e thjeshtë të interesit; me pas interesi i munguar do të llogaritet, duke përdorur formulën e thjeshtë në qoftë se afati është më i shkurtër se një vit dhe formulën e përbërë të interesit në qoftë se afati kalon 1 vit.

Neni 11

Taksat

11.1. Çdo taksë e tanishme ose e ardhme e vendosur në Shqipëri, që do të ketë lidhje me këtë Marrëveshje dhe me Deklaratën e Borxhit, do të jetë vetëm në ngarkim të Huamarrësit.

11.2. Çdo taksë e vendosur në Itali, nuk do të jetë në ngarkim të Huamarrësit.

11.3. Mediocredito Centrale deklaron se do të përfitojë nga regjimi fiskal, me Dekret të Presidentit të Republikës Nr.601, datë 29 Shtator 1973, Ligji Nr.227, datë 24 Maj 1977, i Republikës së Italisë bashkë me amendamentet e lidhura me të.

Neni 12

Zgjidhja e Marrëveshjeve

12.1. Palët do të përpiqen t'i zgjidhin miqsisht mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi dhe/ose ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje.

12.2. Në qoftë se këto përpjekje nuk do të çojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda 90 ditëve (nëntëdhjetë), ato do të zgjidhen në nivel qeveritar.

12.3. Në qoftë se edhe kjo përpjekje do të dështojë, të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Arbitrazhi i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris, Francë, nga një kolegji i përbërë nga tre anëtare.

- Një i caktuar nga Huamarrësi

- Një i caktuar nga Mediocredito Centrale

- Një i caktuar nga Arbitrazhi në fjalë ose kur ata s'bien dakord nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris.

12.4. Në qoftë se Huamarrësi ose Mediocredito Centrale nuk e caktojnë gjyqtarin e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kërkesa e palës tjetër, ky gjyqtar do të caktohet nga Kryetari i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris.

12.5. Vendimi i Gjykatës, që do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës së Italisë, do të jetë detyrues dhe i pakushtëzuar për të dy palët, pa asnjë mundësi apelimi.

12.6. Çfarëdo mosmarrëveshje ose kontradiktë, që do të lindë midis palëve, nuk do të pezullojë detyrimet e Huamarrësit për të paguar në datat e caktuara të gjitha shumat në kuadrin e Marrëveshjes dhe në veçanti të gjitha shumat që rezultojnë në tabelat e shlyerjes, të shprehura në Nenin 6, paragrafi 6.8 dhe në Deklaratën e Borxhit të lidhur me të.

Neni 13

Shënime

13.1. Shënimet në lidhje me Marrëveshjen, do të adresohen si më poshtë:

• QEVERIA E REPUBLIKËS Së SHQIPËRISë, MINISTRIA E FINANCAVE - Tiranë - Shqipëri

• BANKA KOMBËTARE TREGTARE - Bulevardi "Zhan d'Ark" - Tiranë - Shqipëri - N.Telex 2118-2133 NCBA AB

• MEDIOCREDITO CENTRALE - Via Piemonte 51, 00187 Romë-Itali, N.Telex 626496/626497

• INSTITUTI BANKAR SAN PAOLO TORINO SPA - DEGA ROMë - ZYRA ME JASHTË- Via Firenze 8, 00184 Roma - Itali, N.Telex 626185.

Neni 14

Teksti origjinal i Marrëveshjes Financiare

14.1 Kjo Marrëveshje u ekzekutua dhe u firmos në italisht në katër origjinale dhe në anglisht në katër origjinale, në kopje autentike. Varianti i Marrëveshjes në gjuhën italiane do të jetë komandues në rast mosmarrëveshjeje.

NE EMËR Të MEDIOCREDITO
CENTRALE
Qendror për Kredinë Afatmesme

NE EMËR Të QEVERISë Së
REPUBLIKËS Të SHQIPËRISë Instituti

S.P.A.
ROLAND MURORI
Nënshkruar në Romë
6 korrik 1998
(model mandati për Bankën Agjente)

SPIRO BRUMBULLI
Nënshkruar në Tiranë
15 qershor 1998

ANEKSI A

Nga: QEVERIA E REPUBLIKËS Së SHQIPËRISë
Për: INSTITUTIN BANKAR SAN PAOLO TORINO S.P.A. - DEGA E ROMËS
Për: MEDIOCREDITO CENTRALE (kopje)

Marrëveshja Financiare për Lit. 22.000.000 (njëzet e dy miliardë), firmosur nga ne në Tiranë me dhe nga Mediocredito Centrale në Romë me

Ne lidhje me Marrëveshjen e mësipërme, nr ju caktojme ju si Bankën tonë Agjente.

Ju do të hapni, kështu, nga ana juaj një "Llogari me Jashtë" në emrin tonë, në të cilën ju do të kreditoni fondet, që herë pas here, do të vihen në dispozicionin tonë nga Mediocredito Centrale.

Fondet e kredituara nga Mediocredito Centrale në këtë llogari, do të përdoren në të njëjtën kohë dhe në mënyrë ekskluzive për financimin e importimit të mallrave dhe shërbimeve italiane në kuadrin e programit të mbështetjes së bilancit të pagesave, sipas udhëzimeve që ne do t'ju japim në një letër të veçantë në formën e Aneksit C të Marrëveshjes së mësipërme.

Pagesat, që ju do të bëni në favor të përfituesve të treguar nga ne, do t'i nënshtrohen dergimit të dokumenteve kontraktuale të kërkuara nga kontrata e shitësit dhe vërtetimin e shkarkimit të mallit në dy origjinale.

Për më tepër, si thuhet në Marrëveshjen e mësipërme, ju do të dërgoni një origjinal të vërtetimit të shkarkimit të mallit dhe një kopje të dokumenteve kontraktuese Mediocreditos Centrale dhe do të na transmetoni në origjinalin e dyte të vërtetimit të shkarkimit të mallit dhe dokumenteve kontraktues.

Ju lutemi të na konfirmoni ne dhe Mediocredito Centrale, me letër ose telex, të konfirmuar më pas me letër pranimin nga ana juaj, të këtyre udhëzimeve.

I juaji

(model kërkesë për të pasur fondet në dispozicion)

ANEKSI B

Nga: QEVERIA E REPUBLIKËS Së SHQIPËRISë
Për: MEDIOCREDITO CENTRALE

Marrëveshja Financiare për Lit. 22.000.000.000 (njëzete e dy miliardë), firmosur nga ne në Tiranë me datë dhe nga Mediocredito Centrale në Romë me datë

Në zbatim të Nenit 5 të Marrëveshjes së mësipërme, ne ju kërkojmë që ju të vini në dispozicionin tonë, duke kredituar "Llogarinë me Jashtë", të hapur në emrin tonë me Institutin Bankar San Paolo Torino - dega Romë, shumë në Lit. (.....) (shumë e kontraktuar, e mbuluar nga kredia në fjalë).

Ju informojmë, se kjo shumë i korrespondon pagesave të bëra prej nesh për në përputhje me kushtet e kontratës së furnizimit Nr....., datë, ndërmjet dhe, në lidhje me

(projektin), (kopja e të cilit do të dërgohet tek ju nëpërmjet ndërmarrjes italiane përfituese).

Me qëllim që të kryhet shpejt pagesa për, ne kemi urdhëruar Institutin Bankar San Paolo Torino - dega Romë, të bëjë direkt tek ju, herë pas here, kërkesa për të kredituar në "Llogarinë me Jashtë" fondet e nevojshme për të kryer pagesat sipas kontratës së furnizimit me kushtet dhe konditat e specifikuar në të.

Ne në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar, angazhohemi të shlyejmë çdo shumë të kredituar nga ju në "Llogarinë me jashtë" Nr.36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta 6-mujore (këstet principiale), ku i pari skadon 150 (njëqind e pesë dhjetë) muaj nga data e bërjes efektive të Marrëveshjes Financiare të mësipërme.

Ne gjithashtu, angazhohemi të paguajmë interesin e kontraktuar me normë vjetore nominale prej 1% (një për qind) e barabarte me 0.50% (zero pesëdhjetë për qind) 6-mujore, si dhe interesin e munguar, në përputhje me kushtet dhe konditat e vendosura në Marrëveshjen Financiare të mësipërme.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e skadimit të disbursimit të fondit financiar, e shprehur në Nenin 4 të Marrëveshjes Financiare të mësipërme, ne angazhohemi t'i dërgojmë Mediocredito Centrales një Deklaratë të Borxhit mbi shumën kryesore, që i korrespondon shumës së të gjitha disbursimeve të kryera në këtë Marrëveshje.

Kjo deklaratë e Borxhit do të jetë në formën e Aneksit E të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur.

I Juaji

(model i letrës së udhëzimeve për Bankën Agjente)

ANEKSI C

Nga: QEVERIA E REPUBLIKËS Së SHQIPËRISë

Për: INSTITUTIN BANKAR SAN PAOLO TORINO S.P.A. - Dega Romë

Për: MEDIOCREDITO CENTRALE (kopje)

Marrëveshja Financiare për Lit. 22.000.000.000 (njëzet e dy miliardë), e firmosur nga ne në Tiranë më datë dhe nga Mediocredito Centrale në Romë më datë

Në zbatim të përmbajtjes së Nenit 5 të Marrëveshjes Financiare të mësipërme dhe më tej të letrës sonë, dt....., që ju cakton ju si Bankë Agjente, do të gjeni në zarf (përfituesi italian do t'ua sjellë) një kopje të kontratës së furnizimit Nr....., dt....., ndërmjetdhe, në lidhje me (projektin).

Ne ju kërkojmë ju, si Banka jonë Agjente, të kryeni të gjitha pagesat e kërkuara në kontratën e mësipërme të furnizimit, në përputhje me kushtet dhe termat e specifikuar në të, në favor të, për shumën maksimale të Lit. (.....), shumë e kontraktuar për t'u financuar nga kjo kredi financiare.

Për një qëllim të tillë, ne ju kërkojmë që ju të bëni direkt tek Mediocredito Centrale herë pas here kërkesa për të kredituar në "Llogarinë me Jashtë" fondet e nevojshme për të kryer pagesat në kontratën e mësipërme të furnizimit, sipas kushteve dhe termave të specifikuar në këtë kontratë furnizimi (kopje e çdo kërkesë do të na dërgohet me telex).

Kërkesat në fjalë, duhet të ekzekutohen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, duke filluar nga data e pranimit të tyre nga Mediocredito Centrale, duke u siguruar se fondet janë vënë në dispozicion nga autoritetet kompetente të Qeverisë Italiane.

Për këtë qëllim, në i kemi kërkuar Mediocredito Centrales të kreditojë fondet në llogarinë tonë herë pas here sipas kërkesës suaj për pagesat për, në emrin tonë.

Lutemi, na konfirmoni në dhe Mediocredito Centrale, me letër ose telex, i cili duhet të konfirmohet më pas me letër, pranimin nga ana juaj të këtyre udhëzimeve.

I Juaji
(model kërkesë për kreditim)

ANEKSI D

Nga: INSTITUTI BANKAR SAN PAOLO TORINO S.P.A. - Dega Romë
Për: MEDIOCREDITO CENTRALE
Për: QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (kopje)

Marrëveshja Financiare për Lit. 22.000.000.000 (njëzet e dy miliardë) midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, e firmosur në Tiranë me datë dhe në Romë me datë

Në lidhje me Marrëveshjen e mësipërme, sipas urdhrit dhe udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, ne kërkojmë që ju të kreditoni brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës Lit..... (.....) në “Llogarinë me Jashtë”, të hapur me ne në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Kjo shumë do të përdoret në të njëjtën kohë për pagesat në favor të, që rrjedhin nga dokumentet kontraktuale të mëposhtme, të lidhura me kontratën Nr....., datë....., ndërmjet dhe

Në këtë permbajtje, ne vërtetojmë se dokumentet e kontraktuara më sipër, kopje të të cilave do t’ju dërgohen juve bashkë me faturat origjinale të shkarkimit, janë të rregullta dhe konform kontratës që u referohen.

Për më tepër, ne vërtetojmë se pagesat e mësipërme janë në përputhje me ligjet e kontrollit të shkëmbimit të valutës në Itali.

Përshendetje
(model i Njohjes së Borxhit)

ANEKSI E QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr.

Vendi dhe Data e Lëshimit:

Në përputhje me Marrëveshjen Financiare midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrales, firmosur në Tiranë, më dhe në Romë me datë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë deklaron të këtë marrë nga Mediocredito Centrale, shumat e mëposhtme.

Lit..... me

Lit..... me

Kështu, Qeveria e Republikës së Shqipërisë deklaron në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme, të jetë debitore e Mediocredito Centrale, Instituti Qendror për Kredinë Afatmesme SpA me zyre të regjistruar në Romë-Itali, rruga Piemonte 51, për shumën principiale prej Lit. 22.000.000.000 (njëzet e dy miliardë) dhe angazhohet të shlyerje në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta 6-mujore, konsektive, ku i pari duhet të paguhet me dhe i fundit me, sipas afatit të shlyerjes së vendosur më poshtë.

Për shumën principale të detyruar, në këtë njohje të Borxhit, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të paguajë interesat që i referohen afatit të shlyerjes të shprehura më poshtë, të kalkuluara në përputhje me klauzolat e Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur.

.....
(NëNSHKRIMI I HUAMARRËSIT)
Aneksi E (vazhdim)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të shlyejë këstet e principalit dhe do të paguajë interesat e percaktuara në Deklaratën e Borxhit, duke kredituar shumat në Lit. në datat e caktuara, në favor të Mediocredito Centrale ose personave të emëruar, nëpërmjet Institutit Bankar San Paolo Torino - dega Romë, pa komisionet bankare.

Nëqoftëse dega e Romës e Institutit Bankar San Paolo Torino SpA, për çfarëdo lloj arsye, duke përfshirë edhe ato që janë jashtë kontrollit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nuk merr shumat që i detyrohen për principalin dhe interesat në përputhje me këtë Deklaratë të Borxhit brenda datave të caktuara, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të jetë e detyruar t'i paguajë për shumat në fjalë degës së Romës të Institutit Bankar San Paolo Torino, interesin e munguar nga data e caktuar deri në datën e kreditimit në favor të Mediocredito Centrale ose të personelit tjetër të emëruar.

Interesi i munguar në fjalë do të kalkulohet në normën 1% (një për qind) për periudhën e 35 (tridhjetëpesë) ditëve pas datës së caktuar dhe me normën 5% (pesë për qind) deri në datën e kreditimit në favor të Mediocredito Centrale.

Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët pas datës së caktuar, ky interes i munguar do të llogaritet duke përdorur formulën e thjeshtë të interesit, në qoftë se afati është më i shkurtër se një vit dhe duke përdorur formulën e përbërë në qoftë se afati kalon një vit.

Dega e Romës e Insitutit Bankar San Paolo Torino SpA, herë pas here, do të shënojë në këtë Deklaratë të Borxhit çdo pagesë të principalit dhe interesit.

Menjëherë, sapo pagesa e të gjithë kësteve të radhitura në tabelën e shlyerjes më poshtë do të jetë kryer, kjo Deklaratë e Borxhit do t'i rikthehet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Kjo Deklaratë e Borxhit lëshohet në lidhje me kredinë financiare prej Lit. 22.000.000.000 (njëzete e dy miliardë), dhënë konform Nenit 6 të Ligjit Nr.49, datë 26 Shkurt 1987, të Republikës së Italisë.

Tabela e Shlyerjeve

	Data e Maturimit	Këstet e Principalit	Interesat
Totali			
c)			
d)			

.....
(NëNSHKRIMI I HUAMARRËSIT)

Aneksi E

c).....
d).....

e).....
f).....
g).....
h).....
i).....
j).....
k).....
l).....
m).....
n).....
o).....
p).....
q).....
r).....
s).....
t).....
u).....
v).....
w).....
x).....

1).....
2).....
3).....
4).....
5).....
6).....
7).....
8).....
9).....
10).....
11).....
12).....
13).....

.....
(NëNSHKRIMI I HUAMARRËSIT)

14).....
15).....
16).....
17).....
18).....
19).....
20).....
21).....
22).....
23).....
24).....
25).....

35).....

36).....

NËSHKRIMI I HUAMARRËSIT)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë